



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 12.3.2013, e cila filloi në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: prof.dr. Isa Mustafa, Kryetar i Komunës, Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Rexhep Mustafa, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Sarandë Sadriu, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Valon Hiseni, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Fetah Salihu, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Musli Mehaj, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Skënder Reçica, Lumnie Rama, Shefqet Sylejmani, Astrit Hasani, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Shefki Gashi, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mejdiu, Sadri Ramabaja dhe Engin Beyoglu.

Munguan: Afërdita Veliu, Besa Halimi – Zagragja dhe Remzi Pacolli.

Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, të OSBE-së, të INPO-së dhe të mjeteve të informimit.

Mbledhjen e kryesoi **Sami Hamiti**, kryesues i Kuvendit. Ai hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Sadri Ramabaja, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë, të shqyrtohet rasti i fatkeqësisë që ndodhi në oborrin e shkollës fillore "Rilindja" në fshatin Keqekollë, ku ndodhi një tragjedi e rëndë, dhe si pasojë vdiq nxënësi 11 vjeçar, Florenti, i cili nuk mundi t'iu mbijetonte plagëve dhe rrugës për në QKUK ka ndërruar jetë. Kërkojmë që ky rast të shqyrtohet sot, në pikë të veçantë.

Lidhur me këtë rast a ka ndërmarr ekzekutivi i Komunës deri më tash ndonjë veprim, nëse po, atëherë çka keni vepruar, nëse jo, atëherë çka planifikoni të veproni lidhur me këtë rast?

Për ne është tërësisht e papranueshme neglizhenca e organeve mbikëqyrëse që e kanë bërë kontrollin për pranimin teknik të kësaj fushe të sportit të shkollës në Keqekollë. Kjo neglizhencë është njëri ndër faktorët që ka ndikuar në rastin tragjik të Florentit. Kërkojmë nga drejtoritë përkatëse, që të na jepen përgjigje në pikën në shqyrtim.

Lidhur me shqetësimin e z. Ramabaja për rastin e ndodhur në oborrin e shkollës në fshatin Keqekollë, sqarime dha **Halim Halimi**.

Me rastin e vdekjes së nxënësit të kësaj shkolle, kryeseusi i ftoi të pranishmit për një minutë heshtje.

Me shumicë votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua ky

R E N D D I T E :

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit;**
- 2. Raporti vjetor për vitin 2012;**
- 3. Raporti i punës për vitin 2012 i NPR "Pastrimi";**
- 4. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK "Hortikultura";**
- 5. Raporti i punës për vitin 2012 i NPK "Trafiku Urban";**
- 6. Propozimvendimi mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifrat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013;**
- 7. Pyetje dhe përgjigje;**
- 8. Të ndryshme.**

Pika e parë

Sadri Ramabaja bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit, duke thënë se nuk po shënohen emrat e atyre që po votojnë kundër, apo atyre që abstenojnë. Ai kërkoi të respektohet rregullorja dhe të shënohen emrat e atyre që votojnë kundër ose abstenojnë.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit.

Pika e dytë

Lidhur me Raporti vjetor për vitin 2012, kryesuesi hapi diskutimin

Flamur Shala, në emër të GP të LDK-së, tha se ky raport i Kryetarit të Komunës paraqet aktivitetet e organeve komunale gjatë vitit 2012, në përputhje me kërkesat e Ligjit për vetëqeverisje lokale për raportim vjetor pranë Kuvendit komunal. Ky raport paraqet para nesh pothuajse të gjitha aktivitetet e Komunës, duke përmbajtur informacione të nevojshme për punën e të gjitha drejtorive dhe zyrave në kuadër të Komunës. Raporti përmban të dhënat, të cilat i paraqesin të arriturat dhe sfidat e Komunës së Prishtinës për vitin që e lamë pas.

GP i LDK-së mendon se të arriturat e Komunës, sipas këtij raporti vjetor, dalin në fusha të ndryshme. Në fushën e infrastrukturës, investimi në ndërtimin e rrugëve, trotuareve, kanalizimeve atmosferike dhe fekaleve në fshatra dhe në qytete, investimi në rrjetin e ri të ujësjellësit etj., kanë shënuar suksese në këtë fushë të zhvillimit të kryeqytetit. Lëshimi i lejeve të ndërtimit, zgjerimi i i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja e tyre, menaxhimi i mbeturinave etj., gjithashtu zgjerimi i hapësirave shkollore dhe

infrastrukturës arsimore në kryeqytet, modernizimin e QMF-ve, po ashtu edhe pjesën që ka të bëjë me fushën e mirëqenies sociale etj.

Ky kuvend e ka dëshmuar me punë zhvillimin e transparencës, për të cilin është shpërblyer, duke përfutur donacione. Kryetari i Komunës me angazhimin në kryerjen e detyrave, qoftë me politikëbërje, qoftë me zbatim të vendimeve, së bashku ta kenë lehtësuar vendimmarrjen dhe zhvillimin e drejtpërdrejtë të demokracisë të këtij Kuvendi, pavarësisht pengesave dhe sfidave në rrugën e zhvillimit të Prishtinës.

Grupi i këshilltarëve të LDK-së, do ta votojë miratimin e këtij raporti të Kryetarit të Komunës.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, fillimisht shtroi pyetjen se me çfarë arsye deri tani Prishtina si kryeqytet nuk e ka Ligjin e vetë?. Sa i përket numrit të shërbyesve civilë, është dashtë që të jepet edhe numri i punëtorëve të cilët kanë qenë vitin e kaluar, dhe numrin e punëtorëve që janë sot. Për Drejtorinë e Urbanizmit dhe të Infrastrukturës Lokale, do ta shtronim pyetjes se edhe sa punëtorë i nevojiten urbanizmit dhe infrastrukturës, që të plotësohen nevojat e punëve, të cilat kërkohen në Komunën e Prishtinës. Te Drejtoria e Arsimit, vetëm janë përshkruar aktivitetet dhe nuk jepen kurrfarë të dhënash. Në fushën e shëndetësisë nuk vërehen se ka përmirësime, pra kjo kërkon një trajtim më të shpejtë. Në pjesën e Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, thuhet se janë realizuar disa projekte rreth trajnimit të të rinjve në punë, me ndërmarrës për një periudhë të caktuar. Në pjesën e Drejtorisë së infrastrukturës kemi një paqartësi rreth disa rrugëve që janë në ndërtim e sipër, sidomos në zonat rurale, si p.sh. rruga Viti - Bullaj, rrugë e cila ka qenë e paraparë që të shtrohet me asfalt.

Lidhur me Drejtorinë e Kadastrit, është për t'u përshëndetur puna dhe angazhimi i kësaj drejtorie, ndërsa nga Drejtoria e Inspektionit kisha kërkuar sqarim se çka do të thotë se janë trajtuar kaq objekte.

Shemsi Veseli, në emër të GP të PDK-së, tregoi se e kanë analizuar dhe shqyrtuar këtë material, megjithatë shprehu mendimin se ky është një raport shumë voluminoz dhe i kompletuar dhe është për t'u përshëndetur, sidomos tek të hyrat vetjake, ku ka një ngritje, ku ka qenë e planifikuar 35 dhe tash është 36.5. Ky është sukses, por Komuna e Prishtinës ka pasur mundësi që të ketë sukses edhe më të madh te të hyrat vetjake, në veçanti sa i përket lejeve të ndërtimit, legalizimit të objekteve etj. Përkundër të arriturave, brenda këtij raporti ka edhe disa të meta, të cilat është dashur të përmirësohen, veçanërisht te Drejtoria e Financave dhe Pronës është dashtë që të dhënat të paraqiten në kode, nënkode ekonomike, sidomos te harxhimet sa u përket mallrave dhe shërbimeve. Te Drejtoria e Administratës, do të duhej të kishim informata kur pranohen personat në punë, dhe të dihet sistematizimi i tyre, pra të na jepen të dhëna më të sakta rreth

kësaj. Nga Sektori teknik do të duhej të jepej një sqarim më detaj për shpenzimet e bëra, si p.sh. për harxhimin e karburanteve etj. Raporti i auditorit të brendshëm, gjithsesi do të duhej të përfshihej, me disa të dhëna, dhe propozoj që, në njërën nga mbledhjet e radhës të Kuvendit, të raportohet për raportin e auditimit. Edhe Zyra e prokurimit duhet të ketë një raport më të detajizuar. E them këtë, sepse pikërisht Raporti i progresit

edhe në nivelin qendror të Bashkësisë Evropiane, na goditë të gjithë Kosovën të çështja e prokurimit dhe auditimit.

E votojmë këtë raport, por mendoj se do të ishte mirë që, në të ardhmen, këto përmirësime dhe sugjerime të merren parasysht.

Shefqet Sylejmani, në emër të GP të AAK-së, u pajtua me disa vërejtje të dhëna nga parafolësit. Sa i përket buxhetit të vitit 2012, në lartësi prej 61.741.684 €, nga të cilat 35% nga të hyrat vetjake, i rritur për 1.400.000 ose 7% që në masën e përgjithshme mjetesh është 23.2 milion euro, ose 36.5% me pjesëmarrjen e të hyrave vetjake në shumën e përgjithshme totale të buxhetit të Komunës, është tregues që pasqyron qartë performancën e mirë. Duke qenë dëshmitar të vështirësive të raportuara, konsiderojmë që buxheti i Komunës së Prishtinës, domosdoshmërisht duhet të jetë më i lartë, në mënyrë që përafërsisht t'i përmbush kushtet dhe nevojat e domosdoshme të qytetarëve të saj. Mungesa e ligjit për Prishtinën është pengesë e pakapërcyeshme për zhvillimin e mirëfilltë dhe të gjithanshëm. Me gjithë rezultatet e arritura gjatë kësaj periudhe, nuk ka vend për vetëkënaqësi. Është më se i nevojshëm reformimi i mëtejshëm, ngase nuk është bërë sa duhet në formimin e përgjithshëm të administratës, vënies së rendit dhe rregullit, shtimit të disiplinës, si dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë etj. Ka mbetur të punohet edhe më shumë në pastrim më cilësor të qytetit, në Trafikun Urban, në rregullimin e lagjeve dhe qendrës së qytetit, në punët e Inspektoratit dhe konsistencën e tij, me gjithë punën që është duke e bërë Inspektorati. Për ushtrimin e suksesshëm të disa prej kompetencave që i takojnë, por edhe realizimin me sukses të disa prej çështjeve të cekura më lart, është më se i nevojshëm dhe me urgjencë kohore, decentralizimi dhe delegimi i disa kompetencave komunave në përgjithësi, e Komunës së Prishtinës në veçanti, nga niveli qendror, siç janë inspektorët e lëmenjve të caktuar, policia, gjyqësia etj., sepse pa këto nuk mund të bëhet punë.

GP i AAK e mbështet dhe do ta votojë këtë raport.

Shefki Gashi, në emër të GP të LDD-së, tha se ju si strukturë politike dhe ekzekutive, patët fatin që të tejkaloni emergjencën për Prishtinën dhe të hyni në projekte më serioze, më të mëdha. Duke filluar prej hapësirave për shkolla, hapësira për nxënës, ku në këtë periudhë kemi shtuar 10% hapësirë më shumë për nxënës se sa në vitin paraprak. Sa i përket buxhetit, dikur ishte shumë simbolik, por edhe në kushte të tanishme është mjaft solid. Raporti i Kryetarit në përgjithësi është dashur që të përfshijë edhe projektet e pakryera, në mënyrë që të orientohemi më lehtë drejt atyre që kanë mbetur. Preferenca ime është që të orientohemi në nivelin e kuadrit dhe disiplinës në punë. Në fushën e infrastrukturës, kërkoj nga ky kuvendi që të merret një vendim, që të përfundohen ndërtimet e rrugëve në qytet, në lagjet periferike dhe në fshatra brenda vitit 2013. Një problem tjetër mbetet çështja e legalizimit të objekteve, sepse vetëm 70 objekte të legalizuara, është një shumë simbolike.

E përkrahim dhe do ta votojmë këtë raport.

Feti Mehdiu, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se ky raport na ka ofruar një pasqyrë shumë të mirë, shumë të plotë për punën e Komunës për vitin 2012. Megjithatë, është shumë shqetësuese që Prishtina nuk e ka ligjin e vet si kryeqytet. Është për t'u shqetësuar edhe çështja e çerdheve, sepse vetëm dy prej tyre janë të licencuara. Nuk

dihet as numri i fëmijëve nëpër këto çerdhe. Për sa i përket arsimit, tha se nuk ka sa duhet inspektor nëpër shkolla, andaj kërkoj përgjigje se pengesat a janë vetëm në nivelin komunal. Është mirë që ta kemi një pasqyrë për kontrollimin e atyre shkollave. Rreth restaurimit të Hamamit të Madh, tha se duhet të figurojë se është bërë restaurimi i tij, por me ridestinim për një objekt tjetër. Sa i përket garave, është mirë që të jepen informata se kur janë mbajtur dhe kush mori pjesë në to. Edhe rreth furnizimit të bibliotekave, duhet të shënohet numri i saktë i librave, kush i ka dhënë, kush i ka blerë dhe si janë blerë. Në raport thuhet se është blerë një aparat fotokopjues, donacion i USAID-it, mendoj se është shprehje e pasaktë, sepse donacionet nuk blihen.

Ne e përkrahim këtë raport për miratim.

Sadri Ramabaja tha se Raporti vjetor për vitin 2012, është pasqyrë reale e keq menaxhimit të Komunë, pavarësisht përpjekjeve për të vënë në pah disa nga punët e mira që janë kryer, siç e potencuan edhe një pjesë e kolegëve, sidomos ngritja, ndërtimi i objekteve shkollore, ndërtimi i disa rrugëve etj. Por, në fakt shifrat e prezantuara për sfera të ndryshme, por edhe realitetin me të cilin ballafaqohen qytetarët e Prishtinës, më bënë të ndihem keq si pjesëtar i këtij Kuvendi.

Ju kisha lutur që të merrni dhe ta bëni një krahasim me raportin e Komunës së Hanit të Elezit dhe këtij raporti që po e shqyrtojmë sot.

Natyrisht, krahasimi në vëllim në mes dy komunave, njëra shumë e vogël dhe tjetra shumë e madhe, nuk shkon, por në qasje të punës dhe prioriteteve, gjithsesi se do të duhej ta bënim këtë krahasim.

Në fushën e arsimit, sidomos në cilësi, për mos të thënë është e mjerë dhe në degradim, mbetet shumë për të dëshiruar. Këtë problem e shqyrtoam edhe më parë, andaj dhe jemi pajtuar se do të duhej të dilnim prej kësaj gjendje.

Në emër të VV-së, kam shprehur gatishmërinë që të vë në dispozicion pjesën për alternativën qeverisëse në fushën e arsimit dhe të jemi kontributdhënës në njërën prej tribunave të mundshme të mbajtura në nivel komunal, të sjellim ekspertë më të mirë, në mënyrë që të dalim nga kjo gjendje ku është arsimit i mesëm dhe ai fillor, për të cilin jemi përgjegjës si komunë.

Në fushën e ekonomisë, të dhënat që na i ofron ky raport duket se janë vetëm kopje nga raporti paraprak. Për shkak të politikave të gabuara si të nivelit qendror, ashtu edhe atij lokal, shumë biznese, sidomos në fushën e blegtorisë dhe të bujqësisë, janë mbyllur.

Në lëmin e shëndetësisë, për të dalë nga gjendja e rëndë që ka kapluar mjekësinë, kisha propozuar të merret si shembull modeli i Maqedonisë për funksionimin e spitaleve private. Spitalet private do të mund të trajtoheshin në një formë tjetër, duke iu lëshuar hapësirë veprimi, por jo buzë autostradës, por në vende ku do të duhej të jenë.

Këto, dhe një varg të metash tjera, të vërejtura në këtë raport, na bëjnë që të mos jemi formalist këtu, që mos ta votojmë këtë raport.

Naim Makolli bëri kritika lidhur me këtë raport të punës. Lidhur me Drejtorinë e Shëndetësisë, janë të paqarta disa shifra rreth shërbimeve në radiologji. Çështja tjetër është ajo e rrugës Viti - Bullaj, ku në raport thuhet se ajo rrugë është e përfunduar, por nëse dalim në terren e shohim se ajo është një ndër rrugët më të papërfunduara në komunën e Prishtinës. Me ndërtimin e kësaj rruge janë mbyllur dy rrugica të vogla për

dy familje në Bullaj. Problemi tjetër ka të bëjë me shërbimet e shëndetësisë, ku Prishtina është i vetmi kryeqytet që nuk ka fare shërbim sekondar. Rreth investimeve nëpër fshatra, hasim një përpjesëtim jo të drejtë, sepse në raport nuk është theksuar asfaltimi i rrugës në fshatin Marec. Njëherësh kërkoi që të shihet mundësia e ndërtimit të një rrugë Marec - Krilevë. Bëri kritikë edhe për arsimin, konkretisht rreth ndërtimit të shkollave atje ku nuk ka nxënës të mjaftueshëm.

Kimet Zeqa tha se Drejtoria e Shëndetësisë e ka mjekësinë parësore dhe nuk kemi të bëjmë me QKUK-në. Për këtë raport kemi një vërejtje, të cilën edhe disa herë e kam cekur, numri i punëtorëve nuk është i saktë, dhe shoh se në raport shifrat rreth numrit të punëtorëve vetëm janë të përshkruara nga raporti i vitit të kaluar. Nga kjo që është paraqitur në raport, disa nuk qëndrojnë, si p.sh. nuk janë 19 pediatër, nuk janë 8 dermatologë, nuk janë 4 pneumofiziologë etj. Çështje tjetër e që vlen të theksohet është se nuk ka transparencë me Drejtorinë e Shëndetësisë. Këtë e them duke pas parasysh një trajnimi që ishte në Zagreb e Suedi, pra për këtë çështje mungojnë informatat.

Sa i përket furnizimit me barna, edhe pse është përmirësuar dukshëm, mungojnë gjërat më elementare.

Prof. dr. Isa Mustafa i falënderoi të pranishmit për mendimet, vlerësimet dhe kritikën e dhëna për Raportin e vitit 2012, duke thënë se si kuvend i kemi përcaktuar politikat e zhvillimit në vitin 2012. Kemi bërë përpjekje t'i përmbahemi disa prioriteteve, të cilat edhe me Vendimin për buxhetin i kemi përcaktuar si prioritet të përbashkëta, sepse vetë fakti që ka ardhur buxheti këtu, do të thotë kanë ardhur projekte, të cilave ne iu kemi dhënë një prioritet në këtë kuvend dhe atë prioritet e kemi mbajtur. I kemi dhënë prioritet ndërtimit të infrastrukturës, ndërtimit të hapësirave shkollore, ndërtimit të objekteve të kulturës dhe sportit, zgjerimit të hapësirave të gjelbra në qytet dhe mirëmbajtjes së qytetit.

Këto prioritate nuk kemi arritur që t'i realizojmë ashtu siç ne të gjithë kemi dëshiruar, sepse vetë fakti që disa nga këto projekte janë përcjellë për këtë vit, nuk kemi arritur t'i përfundojmë vitin e kaluar, flet se kemi probleme reale në ekzekutimin e punimeve që ndërliken edhe me operatorët privatë, me procedurat e prokurimit, por ndërliken edhe me problemet pronësore.

Në infrastrukturën rrugore është punuar dukshëm, si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Janë ndërtuar shkolla, terrene sportive, çerdhe për fëmijë etj. Sa i përket problemit të shpenzimeve rreth karburanteve, duhet t'i kemi shënimet për të gjitha ato shpenzime. Edhe në disa sektorë të tjerë të fushave të ndryshme, mbetet që të punohet edhe më shumë, siç është çështje e Trafikut Urban, ndërtimi i një ujësjellësi që është më se i domosdoshëm etj. Një prej pengesave në realizimin e shumë projekteve është edhe mungesa e Ligjit për Prishtinën. Tani mbetet që t'i realizojmë ato projekte që bashkërisht i kemi përcaktuar këtu, që edhe në këtë vit të bëjmë korrigjimet që mund të bëhen, dhe të gjitha ato projekte që janë me prioritet dhe që me ligj dhe me rregullore i takojnë Kuvendit, t'i dërgojmë në Kuvend.

Me shumicë votash, pesë kundër (Sadri Ramabaja, Shemsi Veseli, Liridon Restelica, Lumnije Rama dhe Skënder Reçica), u miratua Raporti vjetor për vitin 2012 .

Pika e tretë

Për Raportin e vitit 2012 të NPR "Pastrimi", kryesuesi hapi diskutimin.

Rrahman Ismajli, në emër të Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes rajonale "Pastrimi", i njoftoi të pranishmit rreth funksionimit të kësaj ndërmarrje, duke shtuar se në raport kemi paraqitur të dhënat që kanë të bëjnë me organizimin e kompanisë, veprimtarinë e saj, strukturat kualifikuese, asetet e ndërmarrjes etj.

Në raport gjithashtu është pasqyruar edhe ndihma që është dhënë nga Komuna dhe donacionet që janë dhënë nga Qeveria japoneze dhe GIZ-i.

Nga raporti i drejtorëve shihet se ndërmarrja ka afarizëm të të hyrave të realizuara, me fitim prej 16. 738.70 dhe Komisioni i aksionarëve në raport gjithashtu ka paraqitur edhe objektivat e ndërmarrjes komunale.

Në emër të Komisionit të aksionarëve, ai propozoi që Kuvendi ta miratojë këtë raport.

Tefik Mehmeti tha se do të ishte më mirë që këto raporte të bëheshin në formë më të shkurtër. Sugjeroi që të përdoret forma e Termokosit.

Te pika e dytë, ndaj obligimeve të deponisë së Mirashit, do të shtoja se a ka mundësi që këto marrëveshje të bëhen në bazë të arkëtimit, formë që e ka Kompania "Pastrimi". Për shërbimet ndaj rasteve sociale, duhet të shihet kjo çështje, pasi që ato shpenzime duhet t'i mbulojë dikush dhe numri i rasteve sociale është shumë i madh.

Shefki Gashi propozoi që të merret një vendim, me të cilin obligohet ndërmarrja "Pastrimi" që ta zgjerojë veprimtarinë e saj dhe të kryejë shërbimin në rrjedhjen e lumenjve që bien në liqenin e Badovcit, pasi që nuk po mjaftojnë veprimet "ad hok" që bëhen çdo dy vjet, apo një herë në vit.

Shefqet Sylejmani tha se edhe pse ambienti në Prishtinë është shumë i ndotur, ndërmarrja "Pastrimi" është në nivel të kënaqshëm. Sugjeroi që arkëtarët të takohen me pronarët e shtëpive apo lokaleve, pasi që ndodhë shumë herë kur vetëm lihen faturat e ata nuk shihen kurrë, pra do të ishte më se i domosdoshëm bashkëbisedimi me qytetarin. Këtë raport e përkrahim për miratim.

Kimet Zeqa tha se më intereson të dijë se sa rrugë i ka Prishtina, sepse kështu mund ta kuptojmë sa përqind të rrugëve mirëmbahen.

Shemsi Veseli, shprehu mendimin se kolegët që janë aksionar dhe anëtarët e Bordit të drejtorëve, nuk janë në nivelin e duhur, sepse nuk po e respektojnë ligjin. Raporti ka ardhur i panënshkruar nga Komisioni i aksionarëve. Do të duhej cekur se a është bërë auditimi, sa rekomandime janë nxjerrë, cilat janë ato rekomandime, planin e biznesit, planin e veprimit, planin aksionar dhe atë buxhetor.

Naim Makolli tha se për këtë ndërmarrje kemi fjalë miradije, sepse suksesi i tyre po vërehet në çdo lagje të Prishtinës, në ato periferike dhe nëpër fshatra. Megjithatë, kemi një vërejtje të vogël, sepse është problemi i ditëve të parapara për mbledhje të mbeturinave, por që korrespondojnë me festa të ndryshme, dhe në ato pjesë po kalon java derisa të vije radha e herës tjetër për mbledhjen e mbeturinave. Do të duhej që kjo të merrej parasysh. Ai propozoi që në disa raste kur jepen subvencione për ndërmarrjet publike, me atë shumën që ua japim si subvencion NP, t'ua shlyemë borxhet rasteve me asistencë sociale, për aq sa ka mundësi të u shlyhen.

Mejreme Berisha shprehu brengën e saj lidhur me mosvetëdijesimin e qytetarëve, se kompania “Pastrimi”, është duke bërë një punë të jashtëzakonshme në Prishtinë. Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna, **Agim Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dha sqarime.

Njëzëri u miratua Raporti i punës për vitin 2012 i NPR “Pastrimi”.

Pika e katërt

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Raportin e punës për vitin 2013 të NPK “Hortikultura”.

Vjollca Rizani, në emër të GP të LDK-së, tha se duke e marr për bazë planifikimin e biznesit të kësaj ndërmarrjeje për vitin 2012, mund të themi se gjat vitit 2012 kjo Kompani ka pasur një realizim të plotë të planifikimeve sa i përket ngritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara. Edhe në mirëmbajtjen e sipërfaqeve ekzistuese të gjelbëruara, është punuar konform kontratës, e cila ekziston në Kuvendin e Komunës së Prishtinës. Kjo ndërmarrje ka pasur një bashkëpunim të ndërsjellë edhe me ndërmarrjet e tjera, si me kompaninë e ujësjellësit rajonal “Prishtina” dhe me kompaninë “Pastrimi”. “Hortikultura” në vitin 2012 ka pasur edhe punë shtesë të tjera kontraktuese edhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe me biznese të ndryshme. Në kuadër të këtij projekti janë arritur disa rezultate, janë punësuar disa prej rasteve sociale, mirëmbajtja dhe rehabilitimi i hapësirave publike brenda qytetit të Prishtinës, si dhe ngritja e vetëdijes së qytetarëve në ruajtjen e mjedisit. Këtu janë të angazhuar një numër i madh i punëtorëve profesionalë të këtij lëmi.

Sa i përket raportit financiar, ai është përfshirë në raport. Të hyrat financiare të grumbulluara më herët nga Tregu i automjeteve dhe nga “Laura”, i ja dorëzuar Komunës së Prishtinës. Sa i përket vitit 2012, “Hortikultura” ka operuar me një bilanc pozitiv prej 4352.17 €.

I sugjerojmë Kuvendit të Komunës që të planifikojë një buxhet shtesë, i cili do të shërbejë për vendosjen e sistemit të ujitjes për sipërfaqet e gjelbra në qytetin tonë dhe sugjerojmë që ndërmarrjen ta furnizojë Komuna me mekanizma modern për mirëmbajtjen dhe ngritjen e sipërfaqeve të gjelbëruara.

Astrit Hasani, në emër të GP të AAK-së, tha se në parim ne e përkrahim raportin e kompanisë “Hortikultura”, mirëpo kisha propozuar që në parkun “Gërmia” të bëhet një terren apo shteg për biçikleta dhe ai shteg apo ajo rrugë të ngjyroset me ngjyrë të gjelbër, ku në një farë forme të sensibilizohet shëndeti dhe të quhet shtegu i shëndetit. Propozoj që ky shteg për biçikleta të jetë deri tek “Tauk-bahçja”.

Lidhur me propozimet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit rreth fushëveprimtarisë së Hortikulturës, sqarime dha **Agim Gashi**.

Aziz Pacolli bëri një sugjerim rreth propozimit të ndërtimit të shtigjeve në Gërmia, duke kërkuar që ato të mos zgjerohen, sepse aty veç kanë filluar të futen edhe veturat. Është për ta përsëritur punën e Hortikulturës, se vërtet janë profesionalizuar.

Sa i përket Trafikut Urban, subvencioni që i është dhënë prej 2 milionë euro për blerjen e autobusëve të rinj, mendoj se gjendja në trafik do të përmirësohet dukshëm.

Njëzëri u miratua Raporti i punës për vitin 2013 i NPK "Hortikultura".

Pika e pestë

Për Raportin e punës për vitin 2013 të NPK "Trafiku Urban", kryesuesi hapi diskutimin.

Luan Jusufi, në emër të Grupit të aksionarëve të kompanisë publike komunale "Trafiku Urban", paraqiti Raportin për vitin 2012, duke cekur se në këtë raport i kemi paraqitur të arriturat, vështirësitë, të metat dhe sfidat me të cilat ka vazhduar të ballafaqohet "Trafiku Urban" në vitin 2012.

Në bazë të këtij raporti shihet se edhe gjatë vitit 2012 "Trafiku Urban" ka vazhduar të ballafaqohet me vështirësi në kryerjen e afarizmit të vet, si vështirësi kryesore e kemi cekur vazhdimin e ndërhyrjes së operatorëve ilegalë në linjat e autobusëve të "Trafikut Urban". Vështirësi tjetër ka qenë vjetërsimi dhe amortizimi i autobusëve, ngritja e çmimit të derivateve të naftës gjatë vitit 2012, edhe mos përkrahja e duhur nga Policia e Kosovës dhe Inspektorati komunal për t'i parandaluar dhe për t'i ndëshkuar operatorët ilegalë. Mendojmë se me blerjen e autobusëve të rinj, gjendja në trafikun urban do të përmirësohet dukshëm.

Duke shpresuar që edhe nga Kuvendi komunal janë ndërmarrë hapa konkret që të përmirësohet gjendja, presim nga anëtarët e Kuvendit që ta miratojnë këtë raport pune.

Mejreme Berisha tha se në parim pajtohem dhe do ta përkrahim këtë raport, mirëpo është mospërkrahja nga Policia e Kosovës dhe Inspektorati komunal për të parandaluar dhe ndëshkuar operatorët ilegalë.

Feti Mehdiu tha se në këtë raport do të ndalem vetëm te objektivat që i ka "Trafiku Urban". Dua ta përgëzojë për një angazhim që i ka përfshirë studentët, përveç nxënësve, se ka qenë një propozim i mëhershëm që edhe ata ta rregullojnë çështjen e udhëtimit. Urojmë që kjo ndërmarrje të furnizohet me mjete dhe ngritje të cilësisë të shërbimeve të qytetarëve.

Njëzëri u miratua Raporti i punës për vitin 2013 i NPK "Trafiku Urban".

Pika e gjashtë

Lidhur me Propozimvendimin mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013, të pranishmit i njoftoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, duke shtuar se me nenin 22 të Ligjit për ndërtim,

është paraparë pagesa e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore, ndërsa me nenin 23 të këtij ligji, duke u bazuar edhe në nenin 17 të Ligjit për financa të pushtetit lokal, është dhënë mundësia e caktimit të taksës edhe për ndikimin e dendësisë së popullsisë në infrastrukturë për çdo vit fiskal.

Mustafë Krasniqi, në emër të GP të LDK-së, këtë propozimvendim e kemi shqyrtuar dhe analizuar mirë. Pas gjithë analizës që i është bërë këtij

propozivendimi, ne kërkojmë, te pika 6, paragrafi 1, të lartësia e tarifës nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës që është 13.86 euro për m², për të gjitha hapësirat të pësojë një ndryshim, gjegjësisht hapësirat që janë të parapara për garazhime nën nivelin zero, të lirohen nga tarifat e dendësitetit. Me këtë ndryshim ne do ta përkrahim për miratim këtë propozimvendim.

Kryesuesi tha se propozimi që është, rrjedh për pozicionin e garazhimeve nën nivelin zero, por duhet të dakordohemi këtu që propozimi të dërgohet në Ministri, në mënyrë që ata ta miratojnë.

Aziz Pacolli, në emër të GP të AKR-së, u shpreh i pajtimit me propozimin e dhënë nga përfaqësuesi i LDK-së, dhe lidhur me këtë pyes se a lirohen taksat e parapara me vendimin e mëhershëm. Te neni 7 u përmirësuan ato çka u kërkuar në Komitet për Politik dhe Financa, por një tjetër ka mbetur, objektet individuale të banimit. Kemi thënë se banim individual quhet ndërtimi deri në 450m², kështu që kisha kërkuar një sqarim lidhur me këtë se vërtet deri në 450m², d.m.th. tash është bërë me ligj, nëse është bërë me ligj është tjetër, por vërtet tatimet të cilat i kemi diskutuar në Kuvend çdo herë janë diskutuar rreth kësaj sipërfaqeje.

Liridon Restelica, në emër të GP të PDK-së, tha se kur e kemi analizuar këtë taksë administrative për leje të ndërtimit, një prej shqetësimeve tona që ka qenë për stimulim të tatimit ka qenë puna e taksës për garazhe, por meqë u qartësua nga drejtori nuk po diskutojmë. Më intereson të dijë se sipas propozimit taksa administrative për dhënie e lejeve ndërtimore është 9.96 € m². Është pak shqetësuese se si ka ardhur deri te kjo taksë. Është shqetësuese që janë paraparë 13 makina. Këto 13 automjete a thua për çdo vit duhet të blihen, që janë të llogaritura në këtë taksë, ku thotë që janë nga 15000 € d.m.th. 13 makina. Janë 103 kompjuterë nga 700 €, a duhet të blihen për çdo vit këto, a thua nuk ka asnjë makinë deri më tani, a nuk ka asnjë kompjuter deri më tani? Këto janë ato shqetësimet, të cilat unë i kam parë edhe që janë shumë jashtë parashikimeve që kanë mundur me i shti në kosto të kësaj leje të ndërtimit. Për këtë do dëshiroja përgjigje nga drejtori.

Behxhet Musliu dha sqarime lidhur me shqetësimet e ngritura nga z. Restelica,.

Me propozimin e GP të LDK-së dhe me pajtimin e gupeve tjera për këtë propozim, që pikës 1 të nenit VI t'i shtohet: "taksa për dendësitet të infrastrukturës nuk paguhet për ndërtimet nën nivelin zero (0)", njëzëri u miratua Vendimi mbi taksat administrative për lëshimin e lejes së ndërtimit dhe tarifat për ndikimet nga rritja e dendësitetit të infrastrukturës për vitin 2013.

Pika e shtatë dhe e tetë

Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme

Ajnishahe Azemi, paraqiti kërkesën në emër të shoqatave të personave me nevoja të veçanta si: "Sindrom Daun", "Hendikos", Shoqata e të Verbërve dhe Shoqata e të Shurdhërve, me të cilën kërkohet që Kuvendi i Komunës t'i përkrahë për mbulimin e nevojave të tyre sa më shpejt që është e mundur, nevoja këto të cilat janë të paraqitura në kërkesat e tyre që i kanë drejtuar kohë më parë organeve kompetente të Komunës.

Kërkesë tjetër nga Shoqata e të Shurdhërve, është që Komuna të angazhojë një interpret të gjuhës të shenjave nga një ditë në javë, që do të mundësonte realizimin e shërbimeve të tyre në Komunës, se po hasin në vështirësi në shërbimet komunale.

Kryesuesi dha sqarime lidhur me kërkesat e znj. Azemi.

Rahman Ismajli, pyetje për Drejtorinë e Infrastrukturës Lokale.

Pse nuk është asfaltuar rruga, e cila i lidh fshatrat Rimanishtë - Siçevë - Llukar, rrugë e cila ka qenë e planifikuar të ndërtohet dhe asfaltohet, edhe pse pjesërisht ajo është ndërtuar dhe nuk është asfaltuar, dhe a do të vazhdojë projekti i asaj rruge që t'i lidhë këto fshatra drejt Llukarit.

Hetem Kupina, pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Qytetarët e fshatrave verilindore të Prishtinës, pyesin drejtorin e kësaj drejtorie se cila është strategjia e juaj, gjegjësisht planveprimi i juaj, që qytetarëve të këtyre fshatrave të komunës së Prishtinës të iu ofrohet mundësia për largimin e mbeturinave nga të cilat janë kapluar?

Pyetja e dytë, OSBE-ja, në bashkëpunim me Bashkësinë lokale të Bardhoshit, kanë shprehur gatishmërinë që të investojnë në një projekt jo të madh, në vlerën prej 3000 €, për ndriçimin e një lagjes së poshtme në Bardhosh.

Për tu realizuar ky projekt ata kërkojnë nga Komuna, gjegjësisht pëlqimin nga Drejtoria e Financave dhe e Pronës, se ku do të vendosen katër shtylla, edhe pëlqimin për kyçje në rrjet nga KEK-u.

Lidhur me kërkesën e z. Kupina, **Agim Gashi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, tha se kjo kërkesë është dashtë të drejtohet drejtpërdrejt në drejtori dhe se është obligim i Komunës që t'i kryejë këto projekte, pasi që ato donacione realizohen në marrëveshje me Komunën.

Milazim Vitija pyetje për Drejtorinë e Inspektionit dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Kërkoj që të merren masa në parandalimin e hedhjes së mbeturinave afër rrugës, duke filluar prej Grashtice - Stallovë dhe deri në fshatin Marec.

Po ashtu edhe përgjatë rrugës prej trafo, që njihet si rruga e KFOR-it, e deri në fshatin Hajvali, e tëra ajo pjesë është e mbuluar me mbeturina, kështu që është bartur dheu prej Pallatit të Drejtësisë, është hedhur aty dhe ajo pjesë po thuhet është shndërruar në poligon të plehrave, është bllokuar totalisht edhe kanali i asaj rruge.

Avdush Dobratiqi paraqiti kërkesën e me nënshkrimet nga banorët e fshatit Lebanë, për ndërtimin e xhamisë.

Banorët e fshatit Lebanë kërkojnë nga Komuna ndërtimin e një xhamie, me qëllim që t'iu mundësohet banorëve të këtij fshati kryerjen e ritualeve fetare, si dhe për

edukimin e gjeneratave të reja në frymën islame të paqes. Kërkojmë që xhamia të ndërtohet në një lokacion të pashfrytëzuar që po uzurpohet, e që është në pronësi të Komunës së Prishtinës, afër rrugës magjistrale Prishtinë - Podujevë, në fillim të fshatit Lebanë, që do t'iu mundësonte edhe banorëve tjerë afër këtij fshati për kryerjen e ritualeve fetare. Ne kemi menduar se ky lokacion në hapësirën prej 10.39 arë, me nr. të parcelës 95 - 0, është më i përshtatshmi për ndërtimin e xhamisë. Krahas kësaj kërkesë, paraqiti edhe kërkesën e Bashkësisë Islame, drejtuar Drejtorisë për Financa dhe Pronë, e cila ka kërkuar lejen për ndërtimin e xhamisë në fshatin Lebanë, po në atë parcelë ku është propozuar nga fshatarët.

Mbledhja mbaroi në orën 15:00.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dipl.